

## **YLLKA DEDE**



Audituese e Parë, Departamenti i Auditimit të Performancës

Lindur me 1963. Diplomuar për inxhinieri mekanike(1987). Ka 25 vite pune nga të cilat 17 vitet e fundit në KLSH.

Ekspertiza: Prokurimet Publike.

## **MENAXHIMI I RREZIKUT INSTITUCIONAL NËPËRMJET KONTROLLIT TË CILËSISË<sup>1</sup>**

*nga Yllka Dede*

Kontrolli i Lartë i Shtetit, sikurse çdo institucion, ballafaqohet me një numër rreziqesh gjatë përmbushjes së objektivave të tij. Në këtë kuadër atij i lind e drejta e identifikimit dhe e marrjes së masave ndaj këtyre rreziqeve për të siguruar realizimin e objektivave dhe reputacionin e institucionit.

Rreziqet institucionale potenciale që mund të shfaqen dhe duhen menaxhuar, përfshijnë : dobësitë në planifikimin strategjik dhe vjetor të auditimit, burimet e pamjaftueshme njerëzore, praktikat dhe teknikat e papërshtatshme të auditimit si dhe ndërhyrjet e politikës në program e institucionit, duke kërcënuar pavarësinë e KLSH.

Për të realizuar detyrat dhe objektivat, KLSH-ja, si institucion i ngarkuar për auditimin e jashtëm të sektorit publik, e mbështet punën e saj në planifikimin strategjik afatgjatë dhe afatmesëm dhe në planin vjetor të auditimit, për secilin departament.

Herë ndodh që në planifikim, duke i dhënë përparësi auditimit të subjekteve të gabuara, do të rezultonin paraqitje të raporteve të dobëta të auditimit dhe

dhënia e opinioneve jo të sakta, të cilat do të çonin në humbjen e kredibilitetit të institucionit.

Në praktikën bashkëkohore të auditimit, për të menaxhuar rrezikun institucional, nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit, INTOSAI, janë krijuar Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve të Auditimit Suprem, ISSAI 40, publikuar nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) në dhjetor të vitit 2008, dhe që kanë të bëjnë me Standartet Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë (ISQC) të përshtatura për tu përdorur nga KLSH në botë.

#### Çfarë është kontrolli i cilësisë ?

Koncepti i kontrollit të cilësisë përfshin procedurat e hollësishme operacionale që vendosen dhe zbatohen nga stafi auditues për të arritur cilësinë në procesin e auditimit në kuadër të detyrave individuale të caktuara gjatë auditimit. Këto procedura lidhen me planifikimin, punën në terren, raportimin, ndjekien e zbatimit të rekomandimeve dhe përcaktohen në Manualët përkatëse, sipas tipeve të auditimit.

Monitorimi i cilësisë (shqyrtime të “nxehta”), përfshin monitorimin e cilësisë të auditimeve të veçanta në fazat e planifikimit, punës në terren, raportimit dhe përcakton verifikimet e brendshme të pavarura nga funksionet e auditimit, të cilat duhet të ushtrohen në fazat e rëndësishme të procesit të auditimit për të siguruar që procedurat e kontrollit të cilësisë janë zbatuar si duhet.

Sigurimi i cilësisë, (shqyrtime të “ftohta”) arrihet përmes një kombinimi të rishikimit të brendshëm dhe të jashtëm. Rishikimi i brendshëm i pavarur “pas auditimit”, realizohet në vijimësi gjatë të gjithë vitit, me autorizim të Kryetarit të KLSH, për grupe auditimesh të përzgjedhura në bazë të faktorëve të vlerësimit të rrezikut.

Objektivi i këtij rishikimi të pavarur për sigurimin e cilësisë është që të japë një vlerësim të përgjithshëm për cilësinë e punës audituese, brenda KLSH, bazuar në auditimet kryesore.

Qëllimi i këtij rishikimi të pavarur nuk është të kritikohen grupet e auditimit, por të vihet theksi në ndihmesën që ky rishikim ofron për përmirësimin e praktikave të punës të KLSH.

Gjatë procesit të planifikimit të kontrollit të cilësisë, duke evidentuar problematikat, përcaktohen cilat praktika auditimi do të kontrollohen. Më pas ngrihet grupi i kontrollit të cilësisë. Shqyrtimet për sigurimin e cilësisë ndërmerren për një grup auditimesh, pasi materialet e tyre janë evaduar dhe janë marrë përgjigjet nga subjekti i audituar.

Pas shqyrtimit të dosjeve të auditimit nga grupi i auditimit merren masat që problemet e përbashkëta të konstatuara ti trajtojnë me stafin auditues.

Të gjitha shmangiet nga standardet ose politikat e auditimit të konstatuara, veçanërisht vlerësime të gabuara dhe të meta të përbashkëta të grupeve të auditimit, duhet ti komunikohen, niveleve drejtuese të institucionit përpara hartimit të planit vjetor të auditimeve. Shqyrtimi për sigurimin e cilësisë duhet të nxjerrë në pah edhe praktikat më të mira të auditimit që rezultojnë për periudhën që analizohet.

Në përfundim përgatitet raporti për kontrollin e cilësisë dhe kopja e tij përfshihet në raportin e përvitshëm të veprimtarisë së KLSH që paraqitet në Kuvend.

Në dy vitet e fundit, KLSH i ka dhënë një rëndësi të veçantë kontrollit të cilësisë. Aktualisht nga KLSH u krye kontrolli i cilësisë për punën audituese për vitin 2013.

---

<sup>i</sup> Botuar në Gazetën "Ekonomia" dt. 21 Dhjetor 2013